Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në vitet e kaluara në mënyrë intensive punoi në planin për përgatitje dhe veprim në rast të katastrofave. Vullnetarët dhe të punësuarit e Kryqit të Kuq me sukses u ballafaquan me kriyat e kapluan rajonin tonë (gjendje krize në Bosnje dhe Kosovë, konflikti i brendshëm në Republikën e Maqedonisë në vitin 2001, vërvshimet, zjarret, dëbora, epidemitë, temperaturat e larta enorme). Aktivitetet ishin të përkrahura nga ana e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, nga ana e Programit për zhvillim të Kombeve të bashkuara (UNDP), nga ana e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Zyra e komisariatit të lartë për të ikurit e Kombeve të bashkuara (UNHCR) dhe nga ana e partnerëve dhe agjencive tjera. Aktivitetet e vullnetarëve dhe të punësuarve tanë ishin të vlerësuara pozitivisht nga të gjithë faktorët relevant të shtetit dhe jashtë vendit, që kontribuoi Kryqi i Kuq të bëhet pjesë e sistemit për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim. Një numër i madh i vullnetarëve dhe të punësuarve mbaruan kurse të specializuara në vend dhe jashtë vendit nga fusha e menaxhimit me katastrofa.

Në procesin e përpunimit të këtij dokumenti strategjik Kryqi i Kuq i RM-së i përcjell parimet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq, qëllimet dhe detyrat programore në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë memorandumet për bashkëpunim me Qendrën për menaxhim me kriza të RM-së, Drejtoren për mbrojtje dhe shpëtim të RM-së dhe bashkëpunim me vetëgovernisjet lokale, si dhe procedurat standarde operative të sjellura nga ana e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, UNHCR, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë (KKRM), Strategjia e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe 2020.

Në kuadër të aktiviteteve programore të Kryqit të Kuq funksionon edhe shërbimi për kërkim i cili paraqet pjesë të rëndësishme nga tërësia e veprimit në kushte të katastrofave, konflikteve ushtarake nëpërmjet ndihmës së popullatës së mjeruar dhe lidhjes së personave të shpërngulur dhe të ndarë.

Kompetentet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe disa dekada orvaten për realizimin e lidhjeve familjare. Ky shërbim paraqet esencë në punën e Lëvizjes. Duke potencuar përvojën dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të Shërbimit për kërkim të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, eshtë e pranishme vetëdija dhe vullneti për qasje dhe zhvillim të mëtutjeshëm strategjik të kapacitetit personal dhe marrëdhënieve partnerore. Shërbimi për kërkim eshtë shërbim i posaçëm i organizuar për grumbullimin e dokumentacionit, të

dhënave dhe informatave dhe dhënie të informatave për viktimat e luftës, por edhe për persona të tjerë të cilët janë të ndarë nga familjet e tyre për shkak të gjendjeve tjera të jashtëzakonshme. Shërbimi për kërkim si tërësi strukturore merr vendin e vet në përpunimin e këtij plani strategjik me qasje të planifikuar personale nëpërmjet paraqitjes së qëllimeve dhe aktiviteteve për periudhën strategjike vijuese. Qëllimet strategjike të planit të përgatitjes dhe veprimit në rast të katastrofave dhe shërbimit për kërkim do të drejtohen kah implementimi i Planit strategjik 2020 të KKRM-së.



## ANALİZË E JASHTME

Fatkeqësitë/katastrofat kanë ndikim të madh mbi kushtet e jetës, aktiviteteve ekonomike, si dhe të mirave e shërbimet në vendin e goditur. Pasojat mund të janë afatgjate, bile edhe të rezultojnë me dëme të pakthyeshme mbi zhvillimin, strukturat ekonomike dhe sociale, si dhe mjedisit jetësor.

Pa dallim të asaj se në fakt fatkeqësitë a janë periodike apo i ka nxitur faktori njerëzor, pasojat e tyre dalin nga kombinimi i veprimit të njeriut dhe interaksionit me ciklet apo sistemet natyrore. Katastrofat ndodhin shpesh në botë, ndërsa në kohën më të re, numri dhe intensiteti i tyre rriten. Ato mund të sjellin edhe humbje të mëdha të njerëzve, drejtërsëdrejti apo në mënyrë indirekte (primare dhe sekondare) të godasin pjesë të madhe të popullatës dhe të nxisin dëme të mëdha mbi mjedisin jetësor, si dhe shkatërrime ekonomike dhe sociale me përmasa të mëdha.

Përvoja tregon se katastrofat më shumë nxisin dëme të rëndësishme dhe të pakthyeshme shoqërore në vendet e pazhvilluara dhe në vendet në zhvillim, ku më të vobektit dhe kategoritë më të mjeruara të popullatës e ndjejnë ndikimin më të madh. Nga ana tjetër, në botën e zhvilluar, gjatë viteve të ardhshme edhe një shkallë e madhe dhe e rëndësishme e mbrojtjes nga katastrofat për shkak të mjeteve dhe teknologjisë për sjelljen e masave efektive për preventivë, lehtësim dhe planifikim, si dhe plane për uljen e mjerueshmërisë. Prapë se prapë, edhe këto vende, dëmet u rritën si rezultat i koncentrimit më të madh dhe vlerës së aktiviteteve shoqërore.

Republika e Maqedonisë është e nënshtruar në katastrofa natyrore dhe katastrofa të nxitura nga vet njeriu siç janë tërmetet, vërsimet, zjarret në pyje, rrëshqitja e dheut, epidemitë etj. Disa nga katastrofat janë lokale dhe sezionale, përderisa të tjerat janë të rastit.

Në shfaqjen e vendit në katastrofë ndikon spektri i faktorëve fiziografik, gjeologjik, ekologjik dhe demografik. Faktorë kryesor janë kushtet natyrore, shtuarja e popullatës, rënia e zhvillimit ekonomik, ulja e vazhdueshme e prodhimit të përgjithshëm etj.

Republika e Maqedonisë duke pasur qëllimin që të arrijë kompatibilitet dhe interoperabilitet të plotë me sistemet e sigurisë kolektive, siç janë Aleanca Veri atlantike NATO, Bashkimi evropian (BE) dhe Kombet e bashkuara (KB), në vitet e kaluara, ndërmori masa dhe aktivitete konkrete të cilat janë të drejtuara kah ndërtimi i kapaciteteve institucionale për rezistim dhe ulje të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe katastrofat. Këto masa ishin me karakter sistematik dhe nënkuqtojnë rregullim organizativ, juridik dhe institucional të kësaj problematike.

Për shkak të kësaj Republika e Maqedonisë zbaton sistem për menaxhim me kriza, funksionimi i së cilës është preventiva, paralajmërimi i hershëm dhe menaxhimi me të gjitha rreziqet të cilat mund ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njeriut, të mirat materiale, kulturore dhe natyrore, si dhe sigurinë e përgjithshme të shtetit. Qëllimet e posaçme të këtij sistemi janë të drejtuara kah sigurimi në nivel të vazhdueshëm të konsultimeve dhe koordinimeve mes të gjitha subjekteve kompetente, sjelljen e vendimeve në nivel më të lartë, vlerësim të vazhdueshëm të rreziqeve, reagim në kohë, shfrytëzim efikas dhe adekuat të kapaciteteve dhe resurseve të cilat janë në dispozicion.

Baza fillestare për rregullim në këtë lëmi gjendet në Konceptin nacional për siguri dhe mbrojtje, ku janë të paraqitura qëndrimet dhe ku janë dhënë shqyrtimet strategjike për mënyrën e rregullimit të sistemit për menaxhim me kriza në Republikën e Maqedonisë. Arsyet themelore për shkak të së cilave drejtohet në rregullim të vetëm normativ të kësaj problematike kanë të bëjnë me:


- ▶ Ekzistimin e llojillojshmërisë në rregullimin e kësaj materie me më shumë ligje dhe dispozita tjera dhe mosekzistimi i ligjit të posaçëm;
- ▶ Mosekzistimi i organit të posaçëm shtetëror funksion themelor i së cilit do të jetë trajtimi i kësaj problematike;
- ▶ Ekzistimi i qasjes resore në vlerësimin e gjendjeve dhe mungesa e vlerësimit të vetëm për të gjitha rreziqet;
- ▶ Përmirësimi i koordinimit dhe efikasitetit në përdorimin e resurseve të cilat angazhohen nga më shumë institucionë shtetëror;

Për shkak të rregullimit të plotë në këtë lëmi, zbatimi i sistemit institucional dhe arritja e standardizimit të duhur në zgjedhjet normative me vendet anëtare në NATO dhe BE, si dhe plotësimi i obligimeve nga "Korniza aksionare e konferencës të Hjogo, Kobe, Japoni (2005)" Republika e Maqedonisë në vitin 2005 solli Ligjin për menaxhim me kriza.

Me interes për këto Kahje është kreu 6 i Ligjit "Vlerësimi i sigurisë së Republikës së Maqedonisë", ku rregullohet mënyra e sjelljes së vendimeve, kahjeve dhe rekomandimeve në mënyrë të planifikuar, në kohë dhe të koordinuar për ndërmarrjen e masave të nevojshme, për të cilën përpunohet "Vlerësimi i rezikimit të sigurisë së Republikës nga verifikimi dhe vendosja". Rëndësi të posaçme ka nen 45 i këtij ligji i cili udhëzon në përpunimin e Metodologjisë së vlerësimit të rreziqeve. Gjithashtu, përpuni i këtyre kahjeve bazë të tyre kanë edhe në "Platformën nationale" të zbatuar pak më parë për uljen e rreziqeve nga fatkeqësítë dhe katastrofat, që del nga Korniza aksionare e konferencës nga Hjogo të vitit 2005.

- ▶ **Platforma nationale** zbatohet me bindje se ulja e rreziqeve nga fatkeqësítë dhe katastrofat paraqet prioritet nacional dhe lokal i cili qëndron në bazë të fortë institucionale. E njëta siguron mekanizma nationale për implementimin e Strategjisë nationale për uljen e fatkeqësive, ndërsa Republika e Maqedonisë i përforcon kapacitetet për kooperativitet multisektoral dhe qasja multi e rrezikshme në menaxhimin me rreziqe të ndryshme. Platforma nationale në kontekst të terminologjisë së strategjisë ndërkombëtare për uljen e fatkeqësive nënkuption mekanizëm nacional për koordinim dhe kahje politike për uljen e rreziqeve nga fatkeqësítë të cilat duhet të janë me karakter multisectoral dhe interdisciplinar, me kyçjen e sektorit publik, privat dhe civil, si dhe subjektet ndërkombëtare (duke kyçur agjencitë e specializuara të KB të përfaqësuara në nivel adekuat nacional).
- ▶ **Qendra për menaxhim me kriza** prapë nëpërmjet zbatimit të sistemit për menaxhim me kriza në Republikën e Maqedonisë ka funksion që t'i koordinojë forcat dhe resurset, t'i ndihmojë popullatës gjatë krizave eventuale të shpallura, duke filluar prej veprimtarisë preventive, paralajmërimit të hershëm, dhe deri tek menaxhimi me kriza. Sistemin për menaxhim me kriza e përbëjnë organet e drejtorisë shtetërore dhe organet e pushtetit shtetëror, armata, forcat për mbrojtje dhe shpëtim dhe organet e komunave e të qytetit të Shkupit. Në këtë sistem për menaxhim me kriza janë kyçur edhe ndërmarrjet publike, entet dhe shërbimet, shoqatat e qytetarëve, organizatat joqeveritare dhe humanitare dhe Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë.
- ▶ **Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim** si organ i pavarur i drejtorisë shtetërore përpunon: Plan dhe vlerësim për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësi tjera, organizon dhe përgatit sistemin për mbrojtje dhe shpëtim dhe ekipet përgjigje të shpejtë, bën mobilizimin, siguron rezerva materiale, realizon trajnime dhe ushtrime, realizon bashkëpunim ndërkombëtar, përgatit mekanizmet e rreziqeve, etj.

bëtar, azhuron bazën e të dhënave, vërteton norma dhe standarde dhe kryen punë të vërtetuara me ligj.



Krizat paraqesin rrezik për të mirat, shëndetin, jetën e njeriut dhe të kafshëve, e të cilat kanë ndodhur si shkak i fatkeqësive natyrore dhe epidemive apo rreziqeve tjera, të cilat drejtpërsëdrejti rrezikojnë kushtetutën dhe sigurinë e Republikës së Maqedonisë. Nëpërmjet funksionimit të mirë të mekanizmave, koordinatave dhe bashkëpunimeve të lartpërmendura mes institucioneve relevante do të zbatohet sistem i mirë i funksionimit për preventivë, aktivitet i gatshëm në teren në rast të katastrofave, si dhe aftësi për uljen e pasojave nga fatkeqësitë katastrofë.

## ANALİZË E BRENDSHME

Vendi, roli dhe detyrat e KKRM-së janë të përcaktuara me Ligjin për KKRM dhe Statutin e KKRM-së.

Detyrat e KKRM-së janë të përshkruara në nenin 19 të Ligjit për KKRM-së. Në pikën 14 dhe 15 të nenit 19 të këtij ligji KKRM-së është i obliguar të përgatisë ekipe për shpëtim në ujë dhe male.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë anëtarëson në më shumë organizata ndërkombëtare të cilat janë të autorizuara për kryerjen e edukimit nga fusha e mbrojtjes dhe shpëtimit në ujë, male dhe ndihmë mjekësore. Në Qendrën për Edukim dhe Trajnim të KKRM-së realizon edukim për mbrojtje dhe vetëmbrojtje me ndihmën e instruktorëve të licencuar nga vendi dhe të huaj, përderisa kandidatët marrin certifikata dhe legjitimacione të njohura.

Një numër i caktuar i vullnetarëve të trajnuar nga fusha e mbrojtjes dhe shpëtimit marrin pjesë në Njësinë republikane për përgjigje gjatë katastrofave dhe në ekipet për përgjigje gjatë katastrofave në 34 OKKK.

KKRM-së në planin për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave, ndërtoi marrëdhëniet partnere me struktura përgjegjëse në nivel shtetëror dhe lokal, për shkak të zbatimit të mekanizmave efikase të koordinimit dhe menaxhimit me katastrofa në bazë të Rregullores ligjore.

Në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit në aktivitetet e KKRM-së nënshkroi Memorandum për bashkëpunim me Qendrën për menaxhi me kriza (QMK) dhe Drejtori në për Mbrotje dhe Shpëtim (DMSH), ndërsa në shtabet kryesore të këtyre Drejtiveve ka përfaqësues të KKRM-së.

KKRM-së realizon bashkëpunim të mirë dhe ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim edhe me Ministrinë e mbrojtjes, Armatën e Republikës së Maqedonisë, Ministrinë për punë të brendshme, Ministrinë e shëndetësisë dhe me ministri tjera, me Byronë për zhvillimin e arsimit, Njësitë kundër zjarrit në RM-së dhe institucionet tjera.



Në periudhën e deritanishme, shoqata nacionale ka trajnuar mbi 400 persona për shpëtues në ujë, mbi pesëdhjetë shpëtues në male de rreth 10 persona për shpëtim nga subjektet speologjike dhe shembjeve.

KKRM-së për edukim më masovik të popullatës nga fusha e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes përgatit doracakë të ndryshëm qëllimor, broshura, pamflete dhe postere. KKRM-së si anëtar i Federatës Ndërkontinentare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe realizon bashkëpunim me më shumë shoqata nacionale, e posaçërisht me Kryqin e Kuq të Austrisë, Kryqin e Kuq të Gjermanisë dhe shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq nga të gjitha vendet ballkanike, përderisa me disa ka nënshkruar edhe memorandume për bashkëpunim nga fusha e mbrojtjes dhe shpëtimit (Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë etj). Ky bashkëpunim ndërkontinentar KKRM-së i mundëson të kryejë edukimin e një numri të caktuar të vullnetarëve dhe të punësuarve jashtë vendit.

Në KKRM-së funksionon edhe qendra operative e Kryqit të Kuq, e cila i koordinon aktivitetet e planit t përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave dhe bashkëpunon me Drejtoren për mbrojtje dhe shpëtim dhe Qendrën për menaxhim me kriza të cilat si institucione shtetërore janë bartës të aktiviteteve.

KKRM-së realizon komunikim dhe bashkëpunim të rregullt me shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq dhe OJQ në rajon e më gjerë, me Zonën evropiane të Federatës Ndërkontinentare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe me seli në Budapest, si dhe me Komitetin ndërkontinentar të Kryqit të Kuq me qëllim që të koordinohen dhe realizohen aktivitetet për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave përkrahjen e popullatës së mjeruar.

Duke parë gjendjet në shtet, si dhe dukurinë e shpeshtë të katastrofave me intensitet të ndryshëm vazhdimesh i përforcon resurset materialo – teknike.

## AKTIVITETET E KKRM-së PËR PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE

- Vlerësim i rreziqeve nga katastrofat e mundshme (në bashkëpunim me institucione shtetërore);
- Vlerësim i mjerueshmërisë së bashkësive;
- Vlerësimi i kapaciteteve;
- Përpunimi i planeve për edukim;
- Përpunim i planeve për veprim në rast të katastrofave;
- Përpunim i materialeve informative për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave;
- Fushata mediale për ngritjen e vetëdijes publike për përgatitje dhe mbrojtje nga katastrofat;
- Trajnim i Njësisë nacionale për përgjigje gjatë katastrofave të KKRM-së dhe ekipeve në Organizatat komunale të KKRM-së (OKKK);
- Aktivizim i Njësisë nacionale për përgjigje gjatë katastrofave dhe ekipet e OKKK. (ekipe për: logistikë, ndihmë të parë, ujë dhe sanim, ndërtim të kampeve, përkrahje psikologjike, shërbim për kërkim dhe evidentim, shpëtim nga shembjet etj);
- Organizim të njësive për përgjigje gjatë katastrofave dhe udhëzim të misioneve ndërkontinentare;
- Bashkëpunim me organe shtetërore dhe OJQ në vend dhe jashtë vendit;
- Organizim për grumbullimin, ndarjen dhe distribuimin e ndihmës humanitare;
- Azhurimi i bazës për të dhëna përrreziqe dhe kapacitete të mundshme;
- Organizim të seminareve, kurseve, trajnimeve dhe ushtrimeve nga fusha e katastrofave në nivel të RM-së;
- Përpunim i planit për veprim në rast të katastrofave;

- Menaxhim me kampe;
- Vlerësim në teren të kapluar nga katastrofa;
- Monitorim të aktiviteteve në teren;
- Trajnim për ngritje dhe menaxhim me kamp lagje (sipas programit të Federatës Ndërkombejtare të shoqatave të KK dhe GJHK);
- Trajnim për koordinim dhe komunikim në gjendje krize;
- Trajnim për monitorim dhe evaluim në gjendje krize;
- Trajnim i kolektivit në sistemin arsimor përpunimin e planeve për veprim në rast të katastrofave dhe implementimi i tyre;
- Trajnim i popullatës së gjerë përrreziqet nga ndryshimet klimatike;
- Aktivitete të përbashkëta simulative dhe në teren me institucionet dhe agjencin qeveritare.

## UJË DHE SANIM

- ▶ Edukim i vullnetarëve dhe trajnim i instruktorëve për punë me stacionin për pastrimin e ujit;
- ▶ Edukim për promovimin e higjiënës;
- ▶ Edukim i vullnetarëve për përkrahje teknike gjatë sanimit;
- ▶ Renovim i mjeteve materialo – teknike;
- ▶ Vlerësim në teren për nevojat e ujit për pije;
- ▶ Dhënia e materialit informativ edukativ.

## KURSE

- ▶ Kurse për vlerësim të mjerueshmërisë dhe kapaciteteve;
- ▶ Kurse për vlerësues, para dhe pas katastrofave (Federata Ndërkombejtare e shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe);
- ▶ Kurse – gjashtë hapa për menaxhim me katastrofa dhe ndihmë ndërkombejtare për shoqata nationale;
- ▶ Kurse për zbatim të minimum standardeve për nevojat e popullatës së mjeruar (SFERA);

## BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

- ▶ Këmbim i përvojave dhe praktikave me Komitetin Ndërkombejtare të Kryqit të Kuq, me Federatën Ndërkombejtare të shoqatave të KK dhe GJHK dhe shoqatat nationale;
- ▶ Përgatitje e apeleve për ndihmë humanitare;
- ▶ Pjesëmarrje në punëtori ndërkombejtare për trajnim gjatë katastrofave;
- ▶ Pjesëmarrje në misione ndërkombejtare humanitare;
- ▶ Nënshkrim të marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim.

Në kuadër të funksionimit të deritanishëm shumëvjeçar në planin e përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave, janë arritur shumë rezultate gjatë realizimit të aktiviteteve të planifikuara në planifikimet vjetore strategjike dhe programore. Evaluimi i zbatuar i realizimit të Planit strategjik për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave 2008 – 2010 tregoi se janë realizuar një numër i madh i aktiviteteve të rëndësishme dedikuar përmirësimin e kapaciteteve të shoqatës nationale:

- ▶ Është siguruar softuer Global maper i cili përmban hartë digitale 3D të Republikës së Maqedonisë ku karakterizohen të gjitha rreziqet dhe hapet bazë e të dhënave për secilin rrezik dhe është bërë edhe prezantimi i softuerit në Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim. Në vitin 2010 është zbatuar edukim she instalim i softuerit në të gjitha njësitë rjonale të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim.
- ▶ Janë përpunuar, botuar dhe shpërndarë 54 harta për: fatkeqësi dhe rreziqe nga katastrofat dhe harta fiziko – gjeografike për mikrorajonet Veles, Strumicë dhe Kërçovë, si dhe për komunat: Veles, Çashkë, Gradsko, Strumicë, Vasilevë, Bosillovë, Novo Sellë, Kërçovë, Vraneshticë, Oslloej, Zajaz dhe Drugovë.



- ▶ Janë nëshkruar Memorandume për bashkëpunim me Kryqin e Kuq (Turqi, Bullgari, Bosnie dhe Hercegovinë, Serbi);
- ▶ Në vitin 2010, në organizim të Kryqit të Kuq u organizuan 3 punëtori pilot për "Procedura standarde operative" në Shkup, Ohër dhe Prilep ku morrën pjesë subjektet të cilat janë pjesë e sistemit për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim.
- ▶ KKRM-së morri pjesë në ushtrimet ndërkombëtare simuluese të organzuara nga ana e QMK, DMSH dhe MM, si pjesë e sistemit për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim.
- ▶ Në vitin 2009 në mikrorajonet Strumicë, Veles dhe Kërçovë në përpunim me planet e përpunuara për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësi dhe katastrofa për institucionet arsimore, u përgatiten skenare për evakuim të nxënësve dhe personelit në rast të fatkeqësive dhe katastrofave dhe u mbajtën trajnime – aktivitete ku morrën pjesë të gjitha subjektet të cilat janë pjesë e sistemit për menaxhim me kriza. U përmirësua komunikimi dhe koordinimi me institucionet lokale dhenështë ngritur vetëdija e nxënësve dhe personelit për mbrojtje dhe vetëmbrojtje.
- ▶ Në vitin 2010 mikrorajonet Ohër dhe Strugë u përpunuan plane për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësi dhe katastrofa për institucionet arsimore, janë përpunuar skenarë për evakuimin e nxënësve dhe personelit në rast të fatkeqësive dhe katastrofave dhe u realizuan aktivitete trajnuese ku morën pjesë të gjitha subjektet;
- ▶ Është përmirësuar komunikimi dhe koordinimi me institucionet lokale dhe është ngritur vetëdija e nxënësve dhe personelit për mbrojtje dhe vetëmbrojtje.
- ▶ Në bashkëpunim me KK të qytetit të Shkupit janë aftësuar 10 trajnues për edukim për ngritjen e vetëdijes publike në sistemin arsimor.
- ▶ Janë përgatitur dhe shpërndarë pamflete me përbajtje për mbrojtje në rast të tërmeteve, zjarreve dhe valët e nxehta.
- ▶ Janë realizuar aktivitete për mbrojtje nga ndryshimet klimatike nëpërmjet ligjëratave edukative, ndërsa në periudhat verore me temperaturë e rasteve të larta u ndërmorën masa operative për mbrojtjen e qytetarëve.
- ▶ Nga ana e konsultuesve profesional u përgatit kus me 80 pyetje dhe 250 përgjigje nga fusha e ndihmës së parë, katastrofave dhe shëndetësisë. Është përpunuar internet aplikim në gjuhën maqedonishte nga ana e firmës për teknologji informatike për edukim elektronik ku janë futur të gjitha pyetjet dhe përgjigjet.

Aktivitetet e parapara në Strategjinë 2008 – 2010 janë realizuar dhe dhanë kontribut të posaçëm në realizimin e misionit të KKRM-së në sferën e përgatitjes dhe veprimit gjatë katastrofave dhe mundësuan organizimi të merr vend të posaçëm në sistemin për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim. KKRM-së me kompetencat dhe kapacitetet është korporuar në Procedurat standarde oprative të DMSH dhe QMK, ku është definuar roli i KKRM-së në rast të fatkeqësive dhe katastrofave.

Aktivitetet programore dhe projektuese të KKRM-së të realizuara në periudhën 2008 – 2010 në planin e katastrofave, do të jepin kontribut dhe do të janë pjesë në planin strategjik të KKRM-së për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave për vitin 2012 – 2016.

# Analiza SWOT

## ANËT E FORTA

- Struktura e mirë;
- Kuadër i trajnuar profesional dhe vullnetar;
- Kushte të mira për punë;
- Pajisje materialo – teknike të qendrës;
- Bashkëpunim i mirë me organet shtetërore dhe lokale;
- Bazë e të dhënave;
- Njësi operative për përgjigje gjatë katastrofave;
- Pjesëmarrje në misione;
- Plan i sjellur për veprim;
- Funksionim i qendrës operative;
- Bashkëpunim bilateral me shoqatat nacionale të vendeve bal-ikanike.

## ANËT E DOBËTA

- Pajisje e pamjaftueshme materialo – teknike nga OKKK;
- Mjete të pamjaftueshme financiare për realizimin e aktiviteteve;

## MUNDËSI

- Tërheqja e donatorëve vendor;
- Tërheqje të vullnetarëve të rinj;
- Formimi i EOK në OKKK ku nuk ka;
- Rritja e bashkëpunimit mes OKKK në planin e PDK;
- Përforcim i bashkëpunimit me organet lokale

## KËRCËNIME

- Vjetrim i mjeteve materialo – teknike;
- Shpërndarje e kuadrit profesional dhe vullnetar të trajnuar.

## VIZIONI

Puna jonë e bazuar në parimet universale, ka forcë ta përparojë botën ku jetojmë nëpërmjet promovimit të paqes dhe tolerancës, preventivës efikase, përgjigje në kohë dhe përkrahje adekuate të popullatës së mjeruar.

## MISIONI

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë është organizatë humanitare dhe vullnetare e cila vepron në pajtueshmëri me parimet themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK, duke punuar në planin e sigurimit të ndihmës dhe shërbimeve për popullatën e mjeruar dhe promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe vlerave humane.



# QËLLIME, AKTIVITETE DHE PRITJE

## *Përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave*

Plani strategjik 2012 – 2016 i KKRM-së për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave e pasqyron vendosjen e KKRM-së për drejtimin e aktiviteteve prioritare për menaxhim me sfida me të cilat do të ballafaqohet në pesë vitet e fundit.

Në të janë konsoliduar rezultatet e realizuara nga Strategjia për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave të KKRM-së 2008- 2010, ku si lëndë e interesit janë marrë nevojat specifiket mbindërtimit të kapaciteteve të shoqatave nacionale, përparim të mjeteve vjetra dhe përgatitje të të rejave – metodologji për implementimin e aktiviteteve të cilat do të janë në përputhje me subjektet shtetërore nëpërmjet marrëveshjeve të realizuara partnere.

Rrjeti i zhvilluar i organizatave komunale të Kryqit të Kuq, profesionistë dhe një numër i madh i vullnetarëve na mundëson ti ndajmë nevojat e bashkësive lokale, gjendjet dhe kapacitetet e mjerueshme të cilat i kemi në diskonim.

Mbindërtimi i vazhdueshëm i data bazës, na mundëson përcjellje të vazhdueshme të nevojave të organizatave dhe bashkësive tona në mjeshterit ku veprojnë, përritjen e kapaciteteve të veta, si dhe përgatitje të planeve për përgatitje në rast të katastrofave, por edhe përgjigje në kohë në rast të katastrofave, që është pjesë e qëllimit kryesor i programit për përgatitje dhe veprim në rast të katastrofave.

Që të ngritet vetëdija publike në sistemin arsimor në shtet, KKRM-së, në bashkëpunim me Byronë për zhvillimin e arsimit, Qendrën për menaxhim me kriza dhe Drejtoretinë për mbrojtje dhe shpëtim edhe më tej do të punojë në ngritjen e vetëdijes publike tek rinia e shkollave të mesme për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave.

### **Qëllimi strategjik 1:**

#### **PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE DHE GJENDJEVE NË KRIZË**

### *Aktivitete:*

- ▶ Vlerësim të rreziqeve në bashkësitet;
- ▶ Formim të ekipeve për vlerësim;
- ▶ Ngritje e vetëdijes publike për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave (katastrofa natyrore, katastrofa të nxitura nga vet njeriu) në sistemin arsimor;

- ▶ Ngritje e vetëdijes publike për uljen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike;
- ▶ Implementimi i sistemit për mësim elektronik për vetëmbrojtje dhe mbrojtje në rast të katastrofave;
- ▶ Riorganizim të sistemit për veprim në rast të katastrofave të shoqatës nationale;
- ▶ Përpunim i doracakut – udhëzues për ekipet përgjigje gjatë katastrofave;
- ▶ Sigurim të shërbimeve kyçe (ndihmë humanitare (rezerva mallrash));
- ▶ Promovim i higjenës – ujë dhe sanim.

## Qëllimi strategjik 2:

### RIMËKËMBJE NGA KATASTROFAT

#### Aktivitete:

- ▶ Përkrahje psikologjike për nevojat e popullatës së mjeruar;
- ▶ Përkrahje logjistike në vendosjen e popullatës së mjeruar;
- ▶ Lidhje familjare/shërbimi për kërkim.

## Qëllimi strategjik 3:

### SISTEMI YNË PËR MENAXHIM ME KATASTROFA

#### Aktivitete:

- ▶ Marrëdhënie partnerore me institucione qeveritare dhe joqeveritare;
- ▶ Bashkëpunim bilateral / bashkëpunim rajonal;
- ▶ Regionalizimi i aktiviteteve në planin për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave;
- ▶ Përpunim të procedurave standarde operative për përgatitje, veprim gjatë katastrofave;
- ▶ Implementim i sistemit të vetëm elektronik për menaxhim me katastrofa.

## Rezultate të pritura

- Janë rritur kapacitetet e shoqatës nationale për njëhje të hershme, vlerësim të rreziqeve në bashkësi;
  - Janë formuar ekipe profesionale për vlerësim;
  - Është ngritur vetëdija publike për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave në sistemin arsimor;
  - Është ngritur vetëdija publike për uljen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike;
  - Janë përmirësuar kapacitetet për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave nëpërmjet zbatimit të sistemit elektronik për edukim;
  - Është përmirësuar numri dhe mbajtja e shërbimeve dedikuar për popullatën më të mjeruar;
  - Është siguruar përkrahje psikologjike e popullatës së mjeruar;
  - Është ngritur vetëdija publike në bazë të higjienës – ujë dhe sanim;
  - Janë realizuar lidhje mes personave të ndarë në raste të katastrofave;
  - Është përparuar bashkëpunimi me institucione qeveritare dhe joqeveritare;
  - Interes i rritur i Shoqatës nationale në përmirësimin e bashkëpunimit bilateral / bashkëpunim rajonal.
  - Është zbatuar regjinalizim i aktiviteteve në planin për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave;
  - Janë përpunuuar procedura standarde operative për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave;
  - Është implementuar sistemi i vetëm elektronik për menaxhim me katastrofa;
  - Kontribut i rritur i KKRM-së në sistemin e përgjithshëm për menaxhim me katastrofa në shtet.
- 
- - 
  -

# SHËRBIMI PËR KËRKIM

Shërbimi për kërkim është shërbim i posaçëm i organizuar për grumbullimin e dokumentacionit, të dhënave dhe informatave dhe dhënien e informatave për viktimat e luftës, por edhe për persona tjerë të cilët janë ndarë nga familjet e tyre për shkak të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Komiteti Ndërkombëtar i KK, në bazë të Konventës së Parë të Gjenevës të vitit 1864, e organizoi Shërbimin e parë për kërkim në vitin 1870. Në territorin e vendit tonë Shërbimi për kërkim për herë të parë u paraqit gjatë luftërave ballkanike, në vitin 1912. Me rregullat e të drejtave ndërkombëtare janë ngritur themelet e Shërbimit për kërkim përdherisa me ratifikimin e Konventave të Gjenevës, Republika e Maqedonisë e ndërmori obligimin që ta marrë funksionin e Shërbimit për kërkim.

Vend të posaçëm në aktivitetet e Kryqit të Kuq merr Shërbimi për kërkim. Këtë aktivitet të cilin e ndërmori Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 1993, me nënshkrimin e notifikimit për pranimin e Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokole plotësuese prej vitit 1977, në vitin 1994 me Ligj ia besoi Kryqit tl Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Ky besim ishte shumë herë i arsyetur në vepër, me punën e vullnetarëve dhe të punësuarve të Kryqit të Kuq gjatë krizës së të ikurve nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi (Kosovë) dhe me personat e brendshëm të shpërndarur në konfliktin e armatosur në Republikën e Maqedonisë. Grupet qëllimore të cilët përfshihen në programin e shërbimit për kërkim janë: Popullata e përgjithshme, Vullnetarë dhe profesionistë të punësuar në Shërbimin për kërkim; Përfaqësues të institucioneve qeveritare.

Mirëqenia e njeriut varet në masë të madhe nga mundësia e tij që të jetë në kontakt me të afërmit e tij apo së paku të merr informata për atë se çka u ka ndodhur. Komponentet e ndryshme të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe GJHK me dekada bëjnë orvatje të jashtëzakonshme për realizimin e lidhjeve familjare. Duke potencuar përvojën dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të Shërbimit për kërkim të Kryqit të Kuq të RM-së, e pranishme është vetëdija dhe vullneti për qasje të mëtutjeshme strategjike dhe zhvillim të kapacitetit personal dhe të marrëdhënieve partnerore.

## Qëllimi strategjik:

**Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë kapacetetet e veta ekzistuese në nivel të Kryqit të Kuq të RM-së edhe në nivel lokal i drejton kah përgjigja në kohë e nevojave humanitare të popullatës për realizimin e lidhjeve familjare.**

## Aktivitete

- **Bashkëpunimi me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq** është aktivitet i cili do të jetë i drejtuar kah përkrahja e realizimit të qëllimeve programore dhe strategjike, dhe mbajtja e vazhdimësisë në pjesën e kryesës së aktivitetet për sanimin e pasojave nga katastrofat natyrore dhe realizimi i procedurave të reja për punë në shërbimin në kushte kur sanojen pasojat nga katastrofat natyrore;
- **Organizim i punëtorive për trajnim** përfreskimin e diturive të vullnetarëve dhe të punësuarve profesional të trajnuar në OKKK për punë në Shërbimin për kërkim në OKKK, me qëllim që të mbizotërohen procedurat e reja të punës në shërbimin në rast të katastrofave natyrore;
- **Ndërtimi i marrëdhënieve adekuate me Qeverinë** dhe institucionet qeveritare – ministritë për realizimin e obligimeve informative në rast nevoja nga realizimi i lidhjeve familjare. Shërbimi për kërkim në zgjedhjen e rasteve të të humburve do të ketë nevojë nga këmbimi i informacioneve me ministri të caktuar, për shkak të zgjedhjeve së problemeve në kohë dhe me suskes.




## REZULTATE TË PRITURA

- Anë plotësuar kapacitetet ekzistuese të Shërbimit për kërkim, për realizimin e aktivitetave programore të planifikuara dhe zhvillimit të mëtutjeshëm në Shërbimin për kërkim të përgatitur mirë dhe efikas;
- Janë realizuar relacione pozitive me institucionet qeveritare për zgjedhjen e rasteve konkrete të të humburve.

### *Monitorim dhe evaluim*

Monitorimi do të zbatohet vazhdimesht gjatë planit pesëvjeçar strategjik me proces të vazhdueshëm të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave që të krahasohet suksesi i prioriteteve strategjike, në bazë të rezultateve të pritura. Nëpërmjet evaluimit i cili në mënyrë sistematike do të zbatohet në planin pesëvjeçar, do të jetë vlerësim real i konceptit, implemtimit dhe rezultateve të planit strategjik nëpërmjet së cilisë do të përcaktohet mënya relevante dhe plotësimi i kapaciteteve, efikasiteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria e Planit strategjik.









# STRATEGIC PLAN FOR DISASTER PREPAREDNESS AND RESPONSE

## 2012-2016

Skopje, May 2012

# CONTENTS

Introduction.....	49
External Analysis .....	51
Internal Analysis .....	54
SWOT Analysis .....	59
Vision Statement .....	60
Mission Statement .....	60
Disaster Preparedness and Response Programme.....	61
Strategic aim 1.....	61
Preparing and responding to disasters and crises .....	61
Strategic aim 2 .....	62
Recovering from Disaster and Crisis .....	62
Strategic aim 3.....	62
Our Disaster Management System.....	62
Expected Results.....	63
Tracing Service .....	64
Strategic aim .....	64
Expected Results.....	66
Monitoring and Evaluation.....	66

# INTRODUCTION

A disaster is a serious disruption of the functioning of a community through widespread losses and disruption that exceed the capacities of the communities to cope using their own resources. The disaster may be natural or man made or crisis caused by armed conflicts. The basic objective of our work in such situations is saving lives, reducing suffering, and protecting of the affected population. Our primary goal is to be well prepared and to use all effective means and resources to provide the required support, according to the different needs of the men, women and children – wherever and whenever needed.

Disaster preparedness and response is one of the key priority areas of Macedonian Red Cross. This area covers numerous preventive measures and activities in the area disaster preparedness, disaster response and disaster recovery.

In the past period, Macedonian Red Cross intensively worked in the area of disaster preparedness and response. The volunteers and staff of Macedonian Red Cross successfully coped with the crises in the region (Bosnian and Kosovo crisis, the internal conflict in the Republic of Macedonia in 2001, floods, fires, heavy snowfalls, epidemics, and heat waves).

The activities were supported by the International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, the United Nations Development Program (UNDP), the International Committee of the Red Cross (ICRC), the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) and other partners and agencies. The activities of our volunteers and staff were positively evaluated by all relevant factors in the state and abroad, which contributed Macedonian Red Cross to become part of the crisis management system for protection and rescue. Number of volunteers and staff completed specialized courses on disaster management organized in the country and abroad.

